



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 17
Prishtinë, më 29.03.2018, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Visar Ymeri, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati, Elmi Reçica, Evgjëni Thaçi-Drăgusha dhe Zafir Berisha.

Munguan: Aida Dërguti dhe Sergjan Mitroviç.

Në mbledhje ishte i pranishëm për raportim, Avni Arifi, shef i negociatave me Serbinë, me bashkëpunëtoren, Meliza Haradinaj-Shtublla.

Pjesëmarrësit e tjerë: Driton Selmanaj, deputet; Egnesa Vitija, praktikante; Jeta Krasniqi, KDI; Butrint Berisha, PIPS; Blerta Bejtullahu, EUSR/ EU Office; Shefki Kastrati, NDI; Vlora Nushi, OPA/UNMIK dhe media.

Nga stafi i komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 20, 21, 27 e 28 shkurt dhe 21 mars 2018;
3. Raportim i shefit të negociatave me Serbinë, z. Avni Arifi, lidhur me bisedimet Kosovë – Serbi;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 20, 21, 27 e 28 shkurt dhe 21 mars 2018

Kryetarja konstatoi se komisioni i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 20, 21, 27 e 28 shkurt dhe 21 mars 2018.

3. Raportim i shefit të negociatave me Serbinë, z. Avni Arifi, lidhur me bisedimet Kosovë –Serbi

Vjosa Osmani-Sadriu, njoftoi se janë zhvilluar takime për tri ditë radhazi në Bruksel, të cilat nuk kanë rezultuar me sukses dhe shtoi se është në interes të Kuvendit të Kosovës dhe të qytetarëve që të njoftohen me detajet lidhur me çështjet që janë diskutuar.

Avni Arifi, duke iu referuar raportimit të kaluar para komisionit, njoftoi për vendimin e Interpolit për heqjen nga lista e të kërkuarve. Në këtë listë tha se kanë qenë 18 persona të kërkuar për luftën e UÇK-së, kurse tash kanë mbetur vetëm 2. Lidhur me 2500 rastet gjyqësore, që kanë mbetur në gjykatë, në veri, z. Arifi njoftoi se është formuar një grup i posaçëm me ekspertë nga USAID dhe të tjerë, për t'i klasifikuar këto raste, për të cilat në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe mekanizmat relevantë do të merren veprimet e duhura. Sa i përket takimit në Bruksel, ai njoftoi se kanë propozuar një pako të veprimeve, sa i përket lirisë së lëvizjes, e cila nga ana e Kosovës është e implementuar në tërësi. Me marrëveshjen e implementuar për kthimin e 39 punëtorëve, që do të punojnë në gjendjen civile, është kompletuar infrastruktura e gjendjes civile dhe nuk ka më arsye për qytetarët e pjesës veriore të Kosovës të mos pajisen me dokumente të Kosovës. Lidhur me marrëveshjen për energji, njoftoi se kjo marrëveshje e tejkalon aspektin ndërshtetëror Kosovë – Serbi, duke ndikuar në tërë Evropën. Për ta implementuar sa më shpejtë këtë marrëveshje, z. Arifi bëri të ditur se pjesë e delegacionit të Kosovës ishin edhe përfaqësuesit e Agjencisë për Regjistrimin e Biznesit, për ta regjistruar kompaninë e caktuar në sistemin e ARRB. Më tej, z. Arifi njoftoi se ZRRE ishte e gatshme për të aplikuar për licencimin e KOSST, për t'u bërë pjesë e ENCO-s dhe me këtë do të përfundonte çështja e devijimeve energjetike dhe aspekti i dëmeve financiare që është duke përjetuar Kosova. Po ashtu, z. Arifi njoftoi se delegacioni serb ka qenë i interesuar të diskutojë vetëm për asociacionin dhe jo për tema tjera. Ata kanë pasur një kundërpropozim për marrëveshjen e energjisë, i cili është refuzuar nga ne, sepse ne nuk kemi mandatin e rinegocimit të marrëveshjeve dhe nuk e kemi pranuar atë marrëveshje, njoftoi z. Arifi.

Vjosa Osmani- Sadriu, sa i përket marrëveshjes shtesë për drejtësinë, pyeti: A ka z. Arifi ndonjë informatë, nëse ajo është lidhur? Ajo njoftoi se në takimin e kryetarëve të komisioneve parlamentare, kryetarja e Komisionit për Legjislacion ka njoftuar se gjatë raportimit të Këshillit Gjyqësor në Komisionin për Legjislacion, KGJK ka pranuar se ekziston një marrëveshje e tillë, e cila i është dorëzuar KGJK-së nga institucionet e Kosovës dhe është kërkuar nga KGJK që të implementohet. Kryetarja, lidhur me klasifikimin e lëndëve gjyqësore, pyeti: Në çka bazohet klasifikimi i këtyre lëndëve, cila është baza juridike, dhe nëse ekziston baza juridike, a nënkupton kjo që Qeveria e Kosovës po e pranon këtë marrëveshje shtesë, për të cilën ende nuk dihet se kush e ka nënshkruar, kush e ka arritur dhe kush ka qenë personi që ia ka dorëzuar KGJK-së? Znj. Osmani shprehu mendimin se kjo çështje duhet të sqarohet nga Qeveria e Kosovës, në mënyrë që të mos ketë kontestime, sepse ato vendime janë arritur nga gjykatat paralele, të cilat nuk kanë punuar brenda sistemit juridik të Republikës së Kosovës dhe janë financuar nga një shtet tjetër. Ajo, po ashtu, kërkoi nga Qeveria që të jetë më e zëshme, për ta treguar të vërtetën sa i përket implementimit të marrëveshjeve të arritura, sepse në botë është krijuar përshtypja që Kosova ka ngecur në implementimin e marrëveshjeve e jo Serbia. Sa i përket dialogut, të cilin po e udhëheq Presidenti, pyeti: Çfarë është koordinimi në mes të Qeverisë dhe Presidentit, se a i ka detajet e takimeve të fshehta të Presidentit Thaçi me Presidentin Vuçiç, për temën e asociacionit, si dhe për tema të tjera?

Avni Arifi, sa i përket marrëveshjes për drejtësi, njoftoi se kanë kërkuar, nëse ka ndonjë marrëveshje shtesë dhe përgjigjen që e kanë marrë është se nuk ka marrëveshje shtesë, mirëpo marrëveshjet tjera mund të derivojnë nga marrëveshja kryesore. Mund të ketë ndonjë aneks, për të cilën nuk jam i njoftuar, por besoj që çdo veprim e ka bazën te marrëveshja origjinale, shtoi z. Arifi.

Vjosa Osmani- Sadriu, njoftoi se marrëveshja bazë për drejtësi, e nënshkruar në vitin 2015, nuk flet për njohjen e vendimeve të gjykatave ilegale, pra nuk mund ta ketë bazën aty. Nëse ekziston aneks-marrëveshja, është esenciale që Qeveria ta ketë atë. Lidhur me këtë, pyeti: Si është e mundur që kryetari i KGJK-së po e pranon publikisht në Kuvendin e Kosovës që ekziston ajo marrëveshje?

Avni Arifi, tha se është mirë të kërkohej nga kryetari i KGJK-së, se çfarë nënkupton ajo marrëveshje dhe se këto marrëveshje burojnë nga marrëveshja origjinale. Më tej, tha se nuk është në dijeni për ekzistimin e një marrëveshjeje shtesë. Po ashtu, z. Arifi njoftoi se Qeveria e Serbisë ka një fushatë të fuqishme nëpër të gjitha kryeqytetet dhe pas çdo seance të dialogut, ata dërgojnë informacione se Qeveria e Serbisë i ka implementuar të gjitha marrëveshjet, kurse Kosova nuk e ka implementuar asnjë marrëveshje, mirëpo nga diskutimet që i kemi pasur me mekanizmat relevantë në Bruksel, janë në dijeni se kjo nuk është e vërtetë. Ne e gëzojmë një fajësi të pjesa ndërkombëtare, që nuk kemi proceduar me asociacionin e komunave dhe kërkohej në masë të madhe nga mekanizmat relevantë që Kosova të vazhdojë me hartimin e statutit, njoftoi z. Arifi. Sa i përket komunikimit të Qeverisë me Presidentin, z. Arifi bëri të ditur se Presidenti në dialogun teknik e ka këshilltarin e tij, i cili e informon Presidentin për atë se çfarë ndodh në bisedimet teknike. Njoftoi se Presidenti ka komunikim të vazhdueshëm me Kryeministrin, dhe për të gjitha veprimet gjatë punës së tyre, koordinohen me Kryeministrin.

Vjosa Osmani- Sadriu, tha se nëse Presidenti e ka informuar Kryeministrin dhe Kryeministri iu ka informuar juve, se çfarë ka ndodhur në bisedat për asociacionin, a mund të na tregoni ju se çka saktësisht është diskutuar në ato takime? Ajo pyeti: A pajtohet me deklaratën e Presidentit që të fillojë me procesin e formimit të asociacionit dhe a është Qeveria e Kosovës e involvuar në këtë proces apo është proces që e ka marrë përsipër Presidenti?

Avni Arifi, njoftoi se vendimi për draftimin e statutit dhe vendimi për procedimin e krijimit të asociacionit të komunave është vendim që e merr Qeveria. Ai shtoi se kërkesat e Presidentit janë legjitime, pasi që asociacioni i komunave është obligim ndërkombëtar, të cilin e ka marrë Kosova dhe se asociacioni duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën. Ai njoftoi për përbërjen e grupit punues të formuar nga Qeveria e mandatatit të kaluar, i cili do ta bëjë draftin e statutit, pastaj është edhe një grup tjetër, ku janë të përfaqësuar edhe organizatat, si: OSBE, USAID, ministria, sekretari i përgjithshëm dhe mekanizma tjerë, që do të merren me hartimin e statutit të asociacionit.

Visar Ymeri, tha se pavarësisht ndryshimit të Qeverisë, qasja ndaj dialogut është një vazhdimësi e verbër që ka ndodhur deri më tani. Qasja e Kosovës karshi dialogut, është problematike dhe marrëveshjet që do të dalin nga ky dialog do të sjellin vetëm probleme për Kosovën. Shprehu mendimin se Kosova në këtë dialog niset nga parimi se Kosova është shtet i pavarur dhe sovran, kurse Serbia, në anën tjetër, niset më shumë nga një e vërtetë juridike e veta, nga Kushtetuta e saj dhe në anën tjetër në një realitet faktik në terren. Bashkësia e komunave serbe, tha se është problematike, jo vetëm si formë, por veçanërisht si përmbajtje dhe se pjesët përbërëse të këtyre marrëveshjeve që kanë të bëjnë me resurset ekonomike në pronësi të Republikës së Kosovës, ato përbëjnë në një mënyrë edhe bashkësinë e komunave serbe, si dimension ekonomik të saj. Çfarëdo arritje e marrëveshjes dhe lëshimi pe, nënkupton praktikisht që bashkësia e komunave serbe po ndërtohet pjesë-pjesë dhe se qasja partikulare ndaj dialogut është e gabuar, tha z. Ymeri. Në raport me themelimin e bashkësisë së komunave me shumicë serbe, problem shtesë është se në vend që të ndryshohet dialogu në përmbajtje dhe në tema, ai po ndryshon në profilizimin e dialoguesve nga ana e Kosovës dhe është krijuar një situatë ku për çështje teknike flet ekzekutivi e për çështje politike flet Presidenti. Po ashtu, z. Ymeri e cilësoi si jo serioz hapin që për ta implementuar marrëveshjen për energji, pjesë e delegacioni të Kosovës në Bruksel kanë qenë edhe përfaqësuesit e ARBK-së në Bruksel, për ta regjistruar kompaninë aty. Pyeti: Si e trajton Qeveria marrëveshjen për energji dhe atë për telekomunikacion? pasi që këto marrëveshje nuk janë miratuar në Kuvendin e Kosovës dhe nuk e kanë statusin e një marrëveshje të ratifikuar. Obligimi i Kosovës karshi këtyre dy

marrëveshjeve dhe marrëveshjeve tjera që nuk e kanë këtë status, tha se do të duhej të ishte i ndryshëm me ato që kanë pasur ratifikim. Po ashtu, z. Ymeri pyeti: A ka pasur ndonjëherë në qeveritë e kaluara ose në këtë Qeveri një raport gjithëpërfshirës, në të cilin është bërë publikimi i shkeljes së marrëveshjeve nga ana e Serbisë ose në rastet kur zbatimi i tyre ka qenë i pamundësuar, për shkak të Republikës së Serbisë dhe cili ka qenë propozimi dhe veprimi i institucioneve të Kosovës karshi këtyre çështjeve? Në këtë drejtim, tha se Republika e Kosovës, asnjëherë nuk e ka problematizuar këtë çështje, përveç se është informuar Brukseli. Më tej, pyeti: Cilat janë efektet pozitive të informimit të Brukselit për moszbatimin e marrëveshjeve nga Serbia? A ka Qeveria e Kosovës ndonjë plan B, në rast se nuk mund të merret vesh me Serbinë për funksionalizimin e linjës së koneksionit të lartë me Shqipërinë? Lidhur me kompaninë që do të regjistrohet në veri, pyeti: Çfarë statusi do të ketë ajo ndërmarrje, nëse është publike, a do të themelohet nga Qeveria e Kosovës? Nëse është ndërmarrje brenda strukturës sonë të ligjit, atëherë konsiderohet si ndërmarrje private dhe do të duhej të ndiqen procedurat e privatizimit të një pjese të rrjetit, në këtë rast, me licencimin dhe funksionalizimin e një ndërmarrjeje të tillë.

Avni Arifi, tha se Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, prej vitit 2013 ka insistuar që të ndryshojë forma e dialogut, sepse e kemi pasur bindjen se kjo formë e dialogut nuk po jep rezultate dhe kemi ardhur në një situatë ku po shihet se ka ngecje dhe kjo nuk po jep rezultate të duhura. Më tej, tha se dialogu duhet të përfundojë. Marrëveshjet e nënshkruara janë të rëndësishme dhe duhet të implementohen. Ai tha se e kupton dëshirën e Serbisë që të bisedohet për largpërcuesin, mirëpo nuk është biseduar asgjë që del jashtë marrëveshjes. Sa i përket kompanisë që do të regjistrohet në veri, njoftoi se Qeveria e sheh atë si palë që duhet të regjistrohet. Ai bëri të ditur se Qeveria e Kosovës do të insistojë në forcimin e mekanizmave për implementimin e marrëveshjeve të nënshkruara dhe se do të insistohet edhe në Bruksel, që të implementohen të gjitha marrëveshjet e arritura. Të gjitha kryeqytetet evropiane dhe mekanizmat relevantë janë në dijeni për ngecjet në zbatimin e marrëveshjes për energjinë, njoftoi Arifi.

Dukagjin Gorani, tha se fakti që asociacioni cilësohet si kusht, pa të cilin nuk mund të vazhdohet procesi, tregon se ky nuk është dialog teknik. Këto janë negociata politike, prej të cilave dobinë kryesore e përfiton Republika e Serbisë. Ai shtoi se duke qenë se dialogu nuk ka kornizë dhe ndonjë pikë përfundimtare, Kosova është futur në një situatë të ofrimit të koncesioneve të vazhdueshme, të cilat shkojnë në dëm të qëndrueshmërisë së shtetësisë Kosovës. Më tej, pyeti: Si do të vazhdojë procesi i bisedimeve, nëse merret parasysh se asociacioni i komunave serbe është i pamundur të themelohet në formën në të cilën është nënshkruar, a është e informuar pala serbe që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës e ka pamundësuar themelimin dhe funksionalizimin e tij, në kontekstin e dokumentit që është nënshkruar në Bruksel, në vitin 2013? A mund të vazhdojë ky proces duke mos e përmendur asociacionin e komunave me shumicë serbe? Lidhur me implementimin e marrëveshjeve të nënshkruara, pyeti: A mund që për çdo takim të keni një kapacitet matës të asaj që po implementohet, të asaj që nuk është e implementuar dhe të asaj që nuk është e implementueshme?

Avni Arifi, tha se asociacionit i komunave me shumicë serbe, është më shumë çështje politike sesa teknike dhe duhet të largohet nga konteksti i temave, të cilat i shtjellojmë. Qeveria e Kosovës duhet të ketë qasje kritike edhe ndaj bashkëpunëtorëve tanë ndërkombëtarë, që e lejojnë kushtëzimin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve, me asociacionin e komunave. Rreziku për koncesione duhet të jetë rrezik permanent që duhet ta ketë kjo shoqëri dhe kjo duhet të përfundojë. Ai shprehu mendimin se është e gabueshme që Kosova, në këtë formë të dialogut, të hapë tema të reja dhe nuk do të ketë përfitime, në rast se synohet të ndryshohet forma e dialogut në këtë fazë. Ai tha se janë të interesuar që ta bëjnë një evidentim të të gjitha aspekteve që janë zhvilluar deri më tani dhe shprehu bindjen se delegacion serb nuk ka hyrë në këto bisedime për t'i normalizuar raportet me Kosovën, por ta realizojnë asociacionin.

Zafir Berisha, takimet e palës kosovare në Bruksel i quajti vizita turistike të delegacionit, me të cilat tha se vetëm po zgjaten projektet e Serbisë, duke krijuar një status quo. Serbia, tani është duke bërë politikë të dyfishtë, ku Kosovën e mban peng përmes palës kosovare në bisedime dhe krijon situata të pakëndshme e bëjnë realitet të hidhur në veri. Propozoi që pala kosovare të tërhiqet tërësisht nga ky dialog teknik dhe t'i kthehet seriozisht institucioneve të Kosovës, sepse ky dialog është kryekëput politik. Të gjithë mekanizmat e shtetit, tha se duhet të ulen në tryezë të përbashkët dhe të bëjnë një platformë se si t'i qasen Serbisë dhe të mos bisedohet me të, për rregullim të brendshëm të Republikës së Kosovës.

Avni Arifi, theksoi se janë fajësuar për një vit, që e kanë bllokuar procesin e dialogut, për shkak të proceseve të brendshme, të zgjedhjeve dhe mosëmërimit të shëfit të delegacionit të Kosovës. Në këtë drejtim, tha se ka pasur ide që Serbia të lirohet në rrugëtimin drejt integritimit evropian. Ai i ftoi përfaqësuesit e të gjitha grupeve parlamentare, që të jenë pjesë e këtyre bisedimeve.

Time Kadrijaj, tha se e vlerëson ftesën e z. Arifit që t'i bashkohen dialogut të gjithë ata që duan ta ndihmojnë procesin e dialogut. Më tej tha se është e nevojshme që Kosova në Bruksel të prezantohet si shtet dhe të mos pranoj asgjë shtesë, pos atyre marrëveshjeve që janë arrit. Në procesin e dialogut pala serbe gjithnjë gjen diç shtesë për të mos u implementuar marrëveshjet e arritura. E dimë tha ajo se kemi të bëjmë me proces që nuk është fare i lehtë, duke pasur parasysh se me kë po dialogohet, porse do ta kenë edhe mbështetjen e komisionit.

Zafir Berisha, tha se këto marrëveshje janë antikushtetuese, antiligjore dhe duhet bindur opinionin dhe aktorët politikë se duhet rikthyer një qasje tjetër të bisedimeve. Këto marrëveshje janë të dëmshme dhe jemi në fillim të problemeve të mëdha, të krijuara nga papërgjegjësia e njerëzve të caktuar, duke vepruar pa u konsultuar me ligjet, Kushtetutën, aktorët politikë dhe qytetarët.

Visar Ymeri, duke u ndërlidhur me çështjen e formimit të bashkësisë së komunave me shumicë serbe, theksoi se institucionet e Kosovës duhet ta kenë parasysh se edhe marrëveshja e ratifikuar e vitit 2013 është në shpërputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Bashkësia e komunave serbe, në çfarëdo forme që themelohet, do të jetë në shpërputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, pos nëse formohet një asociacion, i cili nuk ka nevojë për dialog në Bruksel, tha z. Ymeri. Bisedimet e tanishme me Serbinë, si dialog teknik, tha se janë dialog politik dhe pavarësisht se në cilin sektor bisedohet me Serbinë dhe për çfarëdo çështje në negociatë me të, ne bisedojmë për shtetin e Kosovës. Më tej, tha se dialogu në këtë mënyrë krijon një ndjenjë të varësisë së Kosovës dhe se duhet të ekzistojë një distancë e pushtetit që i thotë jo këtij dialogu.

Avni Arifi, theksoi se asnjë temë, e cila bisedohet me Serbinë, nuk është bisedë teknike dhe në secilën temë dhe nivel të ekspertizës dominon politika. Forma si kemi hy në këto bisedime teknike, tha se na ka sjellë në situatë, ku një pjesë e madhe e shoqërisë janë të pakënaqur me përmbajtjen e shumë marrëveshjeve. Më tej, theksoi se në këto bisedime janë të përfshirë edhe mekanizmat ndërkombëtarë dhe qëllimi ynë është që të përfitojmë përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare dhe ta përmbyllim në mënyrë të suksesshme, duke i mbrojtur interesat e vendit tonë dhe të hapim një kapitull të ri, qoftë në raport me Serbinë, qoftë me bashkësinë ndërkombëtare.

Elmi Reçica, theksoi se duke pasur parasysh se 90% të çështjeve të bisedimeve janë politike nuk do të duhej të ftohej sërish z. Arifi në raportim, por të ftohen ata që janë pjesë politike për bisedime apo duhet të parashtrihen pyetje teknike në bazë të raportit. Pavarësisht se asociacioni, a është çështje politike apo teknike, z. Reçica tha se asnjë çështje nuk është teknike, të gjitha janë çështje politike dhe se nuk ka minimum të unitetit, as si parti politike e as si deputetë. Në vazhdim, theksoi se çështja e asociacionit ka hapur shumë çështje të tjera. Pyeti z. Arifin, se pavarësisht mendimit të z. Ymerit, a do të ishte më mirë që të zbatohen obligimet ndërkombëtare, pasi që ato trashëgohen, pavarësisht se kush do të vijë në pushtet.

Vjosa Osmani-Sadriu, theksoi se komisioni do të vazhdojë ta ftojë z. Arifin për të raportuar, sepse këtë e kemi miratuar me planit e punës dhe kemi një dakordim të përbashkët për raportime. Më tej, tha se procesi i dialogut është një proces, të cilin komisioni e monitoron në tërësi, në përputhje me mandatin e tij, sipas Rregullores dhe rezolutave të Kuvendit. Pyetjet e parashtruara nga ana e deputetëve janë në kontekst të sqarimit të situatës dhe në interes publik, tha ajo.

Avni Arifi, në mes tjerash, lidhur me dialogun, tha se qoftë ai teknik apo politik, e ka për qëllim që të informojë gjithë shoqërinë me atë që po ndodh dhe shprehu gatishmërinë që të informojë lidhur me procesin.

Dukagjin Gorani, theksoi se kolegët nga PDK, në vitin 2010, kanë qenë pjesë e procesit të dialogut, jo me qëllim të normalizimit të marrëdhënieve, por me qëllim të marrjes së pushtetit. E njëjta ka ndodhur edhe me Serbinë, që do të thotë se nga fillimi i procesit të dialogut në rajon nuk janë ndërruar pushtetet. Në këtë drejtim, tha se z. Reçica po e merr një pozicion të një determinizmi radikal, se gjërat nuk mund të ndryshohen, përderisa në vitin 2010 kanë bërë çmos për t'u futur në një dialog pa kornizë, me synim të marrjes së pushtetit. Këtë proces ai e quajti të paligjshëm, për të cilin duhet kërkuar llogari dhe i cili duhet të ndryshohet. Ai e falënderoi z. Arifin për raportimin, duke përkrahur pjesëmarrjen e tij edhe në të ardhmen dhe shtoi se ky dialog duhet të përmbyllet me negociata kuptimplote dhe me njohjen e shtetit të Kosovës, si faktor rajonal ndërkombëtar.

Visar Ymeri, tha se mënyrat e trajtimit të diskutimit për dialogun, veçanërisht nga zyrtarë të PDK-së, janë të rrezikshme dhe të pavërteta. Tani ka një vetëdijësim të ri për dialogun, që të mendohet mirë për këtë çështje, tha ai. Nëse ne e kemi vërejtur se shteti po na shkatërrohet me dialogun, atë duhet ta ndalim. Me këtë dialog, integrimi po bëhet përherë e më i pamundur, ndërkohë që nëse vazhdohet dialogu, me të njëjtën logjikë deri në fund, shumë më afër do të jetë ndarja faktike e Kosovës se sa çfarëdo integrimi, sado i vogël brenda kufijve në shoqërinë e Kosovës. Ai theksoi se nuk do të duhej të kishte dialog nga qasja etnike, por qasje të republikës, në të cilën bashkëjetesa do të ishte parakusht i ekzistimit të shoqërisë.

Elmi Reçica njoftoi se ky komision parlamentar, në legjislaturën e kaluar, ka diskutuar lidhur me dialogun, ka dalë në terren dhe ka bashkëbiseduar me qytetarë, ka ftuar në raportime dhe ka qenë mjaftë aktiv në këtë drejtim, por do të duhej një ndryshim në këtë proces dhe reformatim nga mandati i kaluar. Sa i përket çështjeve të ngritura nga z. Gorani dhe z. Ymeri, tha se në esencë nuk qëndrojnë dhe se ata kanë nevojë ta prezantojnë tani, një vijë ndryshe politike. Ai theksoi se PDK, nga viti 2007 deri në vitin 2017, është e fituese e zgjedhjeve. Theksoi se nuk ka diskutuar se bisedimet si të tilla duhet të merren si definitive, porse a duhet të bisedohet me Serbinë në rrethana çfarë ne i kemi tani për çështjet që janë të ngritura. Më tutje, tha se diskutimin e ka bërë në kontest që të gjithë deputetët duhet të jenë bashkë në këtë çështje, që është jetike të jemi bashkë. Më tej, tha se duke pasur parasysh se ka udhëhequr këtë komision, së pari duhet të realizohen marrëveshjet e nënshkruara e pastaj të fillojnë bisedimet për marrëveshjet e tjera. Po ashtu, njoftoi se ka kërkuar që çdo marrëveshje të vijë në Kuvend dhe ceku se me Rezolutë të Këshillit të Sigurimit është caktuar Brukseli, si faktor vendimtar në ndërmjetësimin e këtyre bisedimeve.

Driton Selmanaj, duke u ndërlidhur me procesin negociator, tha se ekipi negociator i raporton Kuvendit, por ideja që në këtë ekip të përfshihen edhe stafi politik i Kuvendit, i Presidencës dhe të partive politike është ngatërresë serioze dhe një mekanizëm i cili po tentohet të krijohet, e që nuk është i paraparë me Rezolutën e Kuvendit. Ai pyeti lidhur me asociacionin, se a ka koordinim me Kryeministrin e vendit dhe se kush po vendos për gjithë përfshirje politike në ekipin negociator.

Avni Arifi, theksoi se në cilësi të shefit të bisedimeve, ka të drejtë që në ekipin e tij të ftojë edhe pjesëmarrës të tjerë dhe është mirë që në ekip të ketë gjithëpërfshirje. Kjo mund të jetë një metodë,

e cila nuk ngjan shpesh, kur Qeveria merr obligime, por ndoshta shoqëria ka nevojë të njoftohet me procesin dhe në praktikë mund të jetë shumë efektive.

Vjosa Osmani, tha se ekzistojnë dy rezoluta të Kuvendit mbi dialogun. E para ka të bëjë me dialogun teknik, ndërsa rezoluta e dytë përfshin edhe pjesën politike, ku në mënyrë të veçantë i jepet rol Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë e Investime Strategjike. Pyeti z. Arifin se cilat janë informatat që i ka nga Presidenti, lidhur me temat që janë pjesë e dialogut Kosovë-Serbi, pasi që komisioni nuk e ka të drejtën kushtetuese ta ftojë Presidentin në raportim. Ajo kërkoi nga z. Arifi që në takimin e radhës të njoftojë se cila është zgjidhja e përkohshme lidhur me energjinë të cilën po e ofron Serbia, si dhe mundësinë e furnizimit me dokumentin e marrëveshjes për drejtësinë dhe atë farmaceutike, e cila do të duhej të ishte në listën e marrëveshjeve.

4. Të ndryshme

Vjosa Osmani-Sadriu, njoftoi se do të nënshkruaj memorandume bashkëpunimi, të cilat nuk krijojnë obligime ligjore, në mes të komisionit dhe disa organizatave joqeveritare. Këto organizata do të ofrojnë mbështetje për grupet punuese të komisionit, që kanë të bëjnë me monitorimin e ligjeve, si dhe me ndërtimin e strategjisë për diplomacinë parlamentare. Për t'i nënshkruar këto memorandume të bashkëpunimit, tha se i duhet pajtimi i komisionit.

Kryetarja konstatoi se komisioni u pajtua që të nënshkruhen memorandumet e bashkëpunimit në mes të komisionit dhe disa organizatave joqeveritare, që ta mbështesin punën e komisionit, pa ndonjë obligim ligjor.

Mbledhja përfundoi në orën 16:10.

E përgatiti:
Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetarja komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu